

20230681386

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ТРУД И СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА

Në bazë të nenit 110 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120 /16, 132/16, 35/18, 220/18, 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20 dhe 67/22) Ministri i Punës dhe Politikës Sociale miraton

### **R R E G U L L O R E** **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIM RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E** **VENDEVE TË PUNËS TË CILAVE STAZHI I SIGURIMIT U LLOGARITET ME** **KOHËZGJATJE TË SHTUAR**

#### Neni 1

Në Rregulloren për përcaktimin e vendeve të punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 284/2021), në nenin 2, në pjesën „MINIERAT“, në titullin „minierat e plumbit dhe zinkut“, dhe nëntitulli „Tubacione nëntokë“, nën vendin e punës „punëtor i minierave në nëntokë“, shtohen këto vende pune:

“serviser ndërrimi për mekanizim minierash	12/18
serviser për mekanizim minierash	12/15
inxhinier serviser	12/15
supervajzor i pajisjes për shpim	12/14
mprehës i pajisjes së shpimit	12/14“

Në titullin „Minierat e bakrit“, nëntitulli "parku i vozitjes", pas vendit të punës "voztës kamioni mbi 7 tonë" shtohen dy nëntituj të ri, me këto vende pune si më poshtë:

“RPE Pastrimi i xeheve të bakrit dhe prodhimi i bakrit katodik”	
„udhëheqës i ndërrimit	12/14
laborant (teknik kimik)	12/14
operator i sorbcionit	12/15
operator i ekstracionit	12/15
operator i elektrolizës	12/15
udhëheqës i objekteve hidroteknike	12/14
operator i objekteve hidroteknike	12/14
pranues i produkteve të gatshme	12/14
higjienist	12/14
makinist, kryepunëtor mjeshtër	12/14
saldator, kryepunëtor mjeshtër	12/14
bravandreqës për mirëmbajtje	12/14

Mirëmbajtje mekanike	
bravandreqës, kryepunëtor mjeshtër	14/12
saldator, kryepunëtor mjeshtër	12/14
bravandreqës mirëmbajtjeje	12/14“

Në pjesën i „ADMINISTRATA DOGANORE“, në titullin „Nëpunës udhëheqës doganash“ vendi i punës “doganier i lartë udhëheqës i ndërrimit” fshihet dhe shtohen dy vende të reja pune si më poshtë:

“udhëheqës ndërrimi	12/15
drejtues ndërrimi	12/15”.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.09-2432/3  
24.3.2023  
Shkup

Ministrja,  
**Јованка Тренчевска, d.v.**